




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 16.04.2018

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 16, nenin 17, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 13, të datës 01.02.2018, bën këtë:

**NJOFTIM
PËR PJESËMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK PËR PROJEKT-RREGULLOREN PËR
TARIFA NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE**

Njoftohen qytetarët, subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe të gjithë të interesuarit e tjerë në Komunën e Fushë-Kosovës, se diskutimi publik është i hapur nga data: 16.04.2018-29.04.2018, për 'Lirimin nga taksat për ushtrimin e aktiviteteve biznesore të subjekteve afariste në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin kalendarik 2018', në vijim:

"Projekt-Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoja komunale".

Për sqarime dhe konsultime lidhur me "Projekt-Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoja komunale", mund të drejtoheni në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, kati përdhes, në ndërtesën e Komunës së Fushë-Kosovës, Rruga 'Tahir Zëmaj'.

Takimi për konsultim publik do të mbahet më datë: **25.04.2018, në orën 11:00h**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në ndërtesën e Komunës. Njoftimi për diskutim publik publikohet në ueb-faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

Përshëndetje!



**Kryetari i Komunës
Burim Berisha**



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA FUSHË-KOSOVË / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
Direktorati për Administratë dhe Personal
Direkcija za Administraciju i Personal

Nr.Br. 63 dt. 16.05 2013
FUSHË-KOSOVË-KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



REGULLORE

PËR

TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA

KOMUNALE

Prill 2013
Fushë-Kosovë

Në bazë të nenit 11, nenit 12, pika 12.2 shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03-L-049, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 13 pika 13.6, shkronja (c) të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 98, të datës 17.08.2012, Kuvendi Komunës së Fushë-Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30.04.2013 miratoi këtë:

R R E G U L L O R E

P Ë R

T A R I F A, N G A R K E S A D H E G J O B A K O M U N A L E

Neni 1

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë lartësinë e taksave, tarifave dhe gjobave për shërbime administrative të Komunës, që u ofrohen personave fizik dhe juridik, të Komunës së Fushë-Kosovës në emër të shërbimeve të Komunës, lëshimit të dokumenteve publike, përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve, apo sipas detyrës zyrtare, ushtrimin e veprimtarisë afariste, shërbime profesionale, pronësisë së automjeteve motorike, taksave për çështje të planifikimit dhe urbanizmit, të hyrave nga qiradhënia, gjobat nga trafiku dhe gjobat për shkeljet e rregulloreve të Komunës.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Përcaktimi dhe mbledhja e të ardhurave nga taksat, tarifat dhe gjobat e Komunës bëhet më qëllim të krijimit të të hyrave të Komunës të cilat do të përdoren për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët.
2. Taksat, tarifat dhe gjobat do të jenë gjithëpërfshirëse për tërë Komunën e Fushë-Kosovës.

Neni 3
Inkasimi i të hyrave

Inkasimi i të hyrave komunale sipas kësaj Rregulloreje dhe ndonjë rregulloreje tjetër të Komunës, urdhërese administrative ose udhëzimi administrativ të nxjerra nga ndonjë institucion tjetër qendror, tarife komunale, dënimi dhe takse do të bëhet, çdo muaj, në tre muaj ose në vit, varësisht prej natyrës së tyre dhe ato do të deponohen në Buxhetin e Komunës / Buxhetin e Kosovës.

Neni 4
Zbatimi dhe Mbikëqyrja

1. Rregullorja do të jetë e zbatuar nën autoritetin e plotë të Komunës dhe mbikëqyrjen nga drejtoritë përkatëse.
2. Taksat dhe tarifat do të llogariten në mënyrë transparente për çdo shfrytëzues sipas standardeve të ATK-së.

Neni 5

Taksat, tarifat dhe gjrobat, duhet të jenë të caktuara në nivel të tillë, ashtu që të mund të mbliidhen nga çdo subjekt pa e cenuar të drejtën e tij për të ushtruar veprimtari.

Neni 6

Drejtoritë përgjegjëse për tarifa dhe pagesa sipas kësaj Rregulloreje janë të obliguara që të mbajnë evidencë në harmoni me dispozitat përkatëse ligjore.

Neni 7

Taksat për Lëshimin e Certifikatave dhe Dokumenteve Zyrtare

1. Lartësia e ngarkesave që do të paguajnë personat fizikë dhe juridikë në emër të shërbimeve apo veprimtarive komunale, do të jenë të specifikuara në tabelën Nr. 1.

N/r	Taksat për Lëshimin e Certifikatave dhe Dokumenteve Zyrtare	Shuma e taksës
1.	Për Ekstraktin e Lindjes	1 €
2.	Për certifikatë të lindjes nga LAL	1 €
3.	Për certifikatë nga LAM	1 €
4.	Për certifikatë nga LAV	1 €
5.	Për certifikatë të statusit martesor	2 €
6.	Për ceremoninë e martesës	15 €

7.	Për certifikatën e vendbanimit	1 €
8.	Për certifikatën e nënshtetësisë	2 €
9.	Vërtetime tjera	2 €
10.	Dhënia e çdo lloji të certifikatës në bazë të 2 (dy) dëshmitarëve	2 €
11.	Deklarata për bashkësinë familjare	2 €
12.	Për ceremoninë e Kurorëzimit jashtë objektit të Komunës	50 €
13.	Legalizimi i fotokopjeve duke e krahasuar me dokumentin origjinal (1 faqe me tekst).	1 €
14.	Vendimi për korrigjimin e emrit personal	5 €
15.	Vendimi për ndërrimin e emrit personal	5 €
16.	Kërkesa për regjistrim të mëvonshëm në LAL dhe LAV	6 €

2. Për shërbimet e përcaktuar nga pika 1 deri në pikën 11 të tabelës Nr. 1, lirohen nga taksat të gjithë qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës të cilët i përkasin kategorive të qytetarëve në vijim:

2.1 Shfrytëzuesit e ndihmës sociale;

2.2 Invalidët e luftës;

2.3 Familjet e Dëshmorëve;

2.4 Veteranët e luftës;

2.5 Invalidët dhe të hendikepuarit;

2.6 Viktimat e luftës dhe bashkëshorti/bashkëshortja fëmijet dhe prindërit e tyre pensionistët (vetëm për dokumente personale).

Neni 8

Taksat, tarifat për ushtrimin e veprimtarisë afariste, profesionale dhe të tjera

1. Për ushtrimin e veprimtarisë afariste do të aplikohen taksat e përcaktuara në tabelën Nr. 2 të kësaj Rregulloreje.

N/r	Veprimtarite/afariste/profesionale dhe të tjera	Shuma e taksës
1	Ndërmarrjet Publike: KEK-u...8000€, PTK...2000€, për Filial...500€ Hekurudha, train...4000€, infra...2000€	
2	Ndërmarrjet Ndërtimore (deri në 5 punëtor)	200€
3	Ndërmarrjet Ndërtimore (nga 5-15 punëtor)	350€
4	Ndërmarrjet Ndërtimore (nga 15-30 punëtor)	500€
5	Ndërmarrjet Ndërtimore (Betonjerkë)	1500€
6	Ndërmarrjet Ndërtimore (Gurthyes)	2500€
7	Ndërmarrjet Ndërtimore (ndërtimi i ulët)	360€
8	Ndërmarrjet Ndërtimore (ndërtimi i lartë)	1530€
9	Ndërmarrjet Ndërtimore (makina të rënda)	1980€
10	Tregti me shumicë e artikujve shtëpiakë joushqimor	500€

11	Tregti me shumicë e produkteve farmaceutike	500€
12	Tregti me shumicë e materialit stomatologjik	500€
13	Tregti me shumicë e mjeteve medicinale dhe ortopedike	500€
14	Tregti me shumicë e makinave, pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit	500€
15	Tregti me shumicë e mbeturinave dhe mbetjeve	500€
16	Tregti me shumicë Kompani (shitja e derivateve me shumicë-Depozitë 1-3	1000€
17	Tregti me shumicë Kompani (shitja e derivateve me shumicë-Depozitë 3-5	2000€
18	Tregti me shumicë Kompani (shitja e derivateve me shumicë-Depozitë 5-7	3000€
19	Tregti të tjera me shumicë p.sh. shitja e druve	200€
20	Tregti Komisionare	300€
21	Shërbimet postare-telefonike	200€
22	Kompanitë që merren me sigurimin e automjeteve, të pasurisë dhe të personave	500€
23	Organizimi i panairove, ekspozitave dhe kompanitë e jashtme	200€
24	Bastoret	500€
25	Automatet dhe klubet e veçanta	600€
26	Tombola në lokalet e mbyllura	100€
27	Veprimtari e pylltarisë	200€
28	Veprimtari e botimit të gazetave	300€
29	Veprimtari e shtypshkronjës.	400€
30	Shtypshkrime të tjera	100€
31	Veprimtari me thyerje të gurit, dhënien e formës dhe finicionin	300€
32	Veprimtaria e grumbullit të plastikës dhe rikoperimin	400€
33	Veprimtari për grumbullimin e mbeturinave metalike dhe riciklimin	700€
34	Tregti e automjeteve të reja motorike	700€
35	Tregti e automjeteve të vjetra motorike	300€
36	Mirëmbajtje dhe riparimi i automjeteve	200€
37	Veprimtari e autolarjes	150€
38	Tregti e pjesëve dhe mjeteve të automjeteve motorike	200€
39	Tregti e pjesëve dhe mjeteve për makina byjqësore	100€
40	Tregti me pakicë e karburanteve dhe lubrifikanteve (Zona urbane)	800€
41	Tregti me pakicë e karburanteve dhe lubrifikanteve (Zona rurale)	500€
42	Veprimtari për ndërmjetësim në tregtinë me shumicë	200€
43	Tregti me shumicë e produkteve bujqësore bruto dhe të kafshëve të gjalla	200€
44	Tregtia me shumicë e produkteve ushqimore	500€
45	Tregti me shumicë e luleve	150€
46	Tregtia me shumicë e materialit ndërtimor	500€

47	Tregti me shumicë e librave	
48	Tregti me pakicë e produkteve farmaceutike	100€
49	Tregti me pakicë e kompjuterëve	200€
50	Tregti me pakicë e pajisjeve sanitare	200€
51	Tregti me pakicë e produkteve tjera në dyqane të specializuara	200€
52	Tregti me pakicë e aparateve elektrike, radiove dhe aparateve TV	250€
53	Tregti me pakicë e mobilie të mesme.....300€ dhe të mëdha	650€
54	Veprimtari argjendar – artar	150€
55	Veprimtaria e orëve	100€
56	Veprimtaria me barnatore bujqësore me pakicë.....300€ dhe me shumicë	500€
57	Veprimtaria ndërmarrjet prodhuese mullinjët dhe shitja e drithrave	350€
58	Komunikacioni rrugor (përpos komunikacionit të qytetit)	300€
59	Auto -taxi	40€
60	Veprimtaria e transportit rrugor të mallrave (transporti i veturave)	200€
61	Veprimtari e agjencisë së udhëtimit dhe turizmit	200€
62	Veprimtari për dhënien e automobilitave me qira	150€
63	Veprimtari Auto-Limar	200€
64	Subjekti që merren me ndërmj. në transaksionet e pasurive të patundshme	500€
65	Veprimtari për pastrimin e objekteve	100€
66	Veprimtaria për rregullimin dhe montimin e taksimetra të automjeteve	150€
67	Arsimi në nivel të mesëm	500€
68	Arsimi Universitar	1000€
69	Veprimtari e spitaleve	1000€
70	Veprimtari e çerdheve	200€
71	Veprimtari lidhur me pastrimin dhe evitimin e ujërave ndotëse, trajtimin e hedhurinave, veprimtaritë sanitare e të ngjashme	100€
72	Ndërmarrje për blerjen dhe distribuimin e filmave	200€
73	Veprimtari e radios dhe e televizionit	200€
74	Veprimtari atelieje	100€
75	Veprimtari e produksionit muzikor	100€
76	Veprimtari për punët përfundimtare në ndërtimtari	200€
77	Veprimtaria e mjekësisë familjare (Poliklinika)	500€
78	Ndërmarrje e shërbimeve hoteliere - hotel	700€
79	Motel	200€
80	Motel-Restoran	450€
81	Bankë	700€
82	Agjenci financiare	100€
83	Veprimtari për sigurimin fizik të objekteve dhe të personave	200€
84	Veprimtari e agjencisë së sigurimit dhe të fondeve personale	200€
85	Këmbimore	100€
86	Veprimtaria avokaturë	200€
87	Veprimtari për këshillim lidhur me afarizëm dhe administrim	100€
88	Veprimtari e ndërmarrjes projektuese-profesionale dhe	200€

	agjencitë "Consalting"	
89	Veprimtaria për këshillim dhe sigurimi të pajisje programore	100€
90	Veprimtaria për kontrollimin teknik të automjeteve	400€
91	Veprimtaria e praktikës së ortopedisë	100€
92	Veprimtaria stomatologjike 1 Karrigë..100€, 2 Karriga..150€ dhe 3 Karriga	200€
93	Veprimtaria e mjekësisë primare dhe të pediatriisë	200€
94	Veprimtari për shkollimin e shoferëve - autoshkolla	150€
95	Veprimtaria lotari	500€
96	Veprimtaritë Sportive fushat të hapura.....150€ dhe të mbyllura	250€
97	Tregtia me pakicë, plastikë dyer dhe dritare	600€
98	Tregtia prej drurit dyer dhe dritare	500€
99	Tregtia e Gjeneratorëve dhe pjesëve me pakicë	450€
100	Tregtia e Gjeneratorëve	350€
101	Tregtia e Gjeneratorëve me shumicë	650€
102	Hipërmarketet	900€
103	Supermarketet	600€
104	Minimarketet	400€
105	Marketet	200€
106	DPT në qytet ushqimore	110€
107	DPT në periferi të qytetit ushqimore	100€
108	DPT në fshatra fshat ushqimore	90€
109	Veprimtaritë: byrektore, bukëpjekës embëltoje dhe prodhime tjera nga brumi	150€
110	Veprimtari për montimin e sistemit të alarmeve	150€
111	Veprimtari: piceri, qbaptore, hamburger, ushqim i shpejtë	150€
112	Kafeteri	150€
113	Kafe-çajtoje, kafe-bar	150€
114	Gjellëtore	150€
115	Veprimtari për parkimin e automjeteve - autoparking	150€
116	Veprimtari publicitare	150€
117	Veprimtaritë	
118	Sallon ondulimi për femra, 1 Karrigë 100€..2 Karriga..150€...3 Karriga	200€
119	Sallon ondulimi për meshkuj, 1 Karrigë 80€..2 Karriga...140€..3 Karriga	170€
120	Tregti me pakicë e pjesëve të makinave autove	350€
121	Tregti me pakicë e artikujve të sportit	100€
122	Tregti me pakicë e artikujve të imët metalikë dhe materialit instalues	200€
123	Tregti me pakicë e lodrave	100€
124	Tregti me pakicë e enëve shtëpiake	200€
125	Deri në 50m ² - 100€,.....prej 51-100m ² -150€,.....mbi 101m ² -200€	100/200€
126	Tregti me pakicë e artikujve të imët të përzier (1.25 cent)	150€
127	Tregti me pakicë e artikujve kozmetikë	100€
128	Tregti me pakicë e tekstilit	150€
129	Tregti me pakicë e veshjeve	150€
130	Tregti me pakicë e perdeve	150€

131	Tregti me pakicë e këpucëve dhe artikujve të lëkurës	150€
132	Tregti me pakicë e aparateve të ndriçimit	250€
133	Tregti me pakicë e artikujve të imët, ngjyrave dhe llaçit	200€
134	Tregti me pakicë e librave, fletoreve e tjera	150€
135	Tregti me pakicë e bizhuterisë	100€
136	Tregti me pakicë e suvenireve dhe artizanaleve	100€
137	Deri 50m ² -50€, 51-100m ² -80€, 101-200m ² -100€, 201-500m ² -300€, 501-1000m ² -500€, 1000-2000m ² -750€, 2000-2500m ² -1000€	50/1000€
138	Tregti me pakicë e huleve	50€
139	Tregti dhe servisim të aparateve kundër zjarrit	50€
140	Veprimtari internet-kafe	50€
141	Ofrim këshillash për pajisje llogaritëse	50€
142	Mirëmbajtje dhe riparim të makinave llogaritëse për pajisje informative	50€
143	Veprimtari fotograf	50€
144	Veprimtari fotokopje	50€
145	Veprimtari për fotografimin e dhëmbëve	50€
146	Veprimtari e veterinarisë	50€
147	Veprimtari të ndryshme sportive	50€
148	Veprimtari biliardo	50€
149	Shërbime profesionale	50€
150	Veprimtari për prodhimin e petëve	30€
151	Veprimtaria çantapunues	30€
152	Veprimtaria për punimin e vulave - vulëpunues	30€
153	Veprimtari riparimesh	30€
154	Veprimtari reklamash, lokal ekspozues, si dhe lokalet dhe qoshqet deri në 6 m ²	30€
155	Veprimtari larje dhe pastrim kimik	30€
156	Veprimtari për shitjen e kurorave dhe funeraleve	30€
157	Veprimtari për kujdesin dhe mirëmbajtjen trupore	30€
158	Veprimtari të tjera shërbyese	30€
159	Veprimtari të kabinave telefonike	50€
160	Veprimtari hortikultura-sera 100-200m ² -100€, 300-500m ² -200€ dhe 600-1000m ² -250€	100/250€

2. Taksat nga tabela numër 2 e kësaj Rregulloreje, do të paguhën në bankat e autorizuar dhe do të aplikohen brenda kufijve të Komunës së Fushë-Kosovës, në baza vjetore me mundësi pagese në dy këste.
3. Subjekteve afariste, të cilat pësojnë dëme të konsiderueshme materiale (zjarri dhe të ngjashme), lirohen nga taksa komunale për tri vitet në vijim.
4. Subjekteve afariste të licencuara, të cilat aktivitetet afariste i zhvillojnë në më shumë se në dy objekte afariste atëherë për veprimtari të zhvilluar në çdo objekt afarist do t'iu llogaritet taksa komunale 50%, bazuar në veprimtarinë që zhvillojnë, sipas tabelës numër 2 të kësaj Rregulloreje.
5. Subjektet afariste, të cilat aktivitetet afariste i zhvillojnë në Komunën e Fushë-Kosovës kurse selinë e kanë në ndonjë komunë tjetër në Kosovë, do të përmbushin obligimet (tarifën komunale) në përputhje me kategorizimin e cekur në tabelën numër 2 të kësaj Rregulloreje.

Neni 9
Tarifat në transaksion të pronës

1. Tarifa në transaksion paguhet pas llogaritjes së taksës, e cila bëhet me vendim nga shërbimi i transaksionit të pronave të organit kompetent për pronë në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2012 për tarifat e shërbimeve dhe produkteve kadastrale të ofruara nga Zyrat Kadastrale Komunale dhe kompanite gjeodete të licencuara.
2. Për njësi do të ngarkohet çdo blerës, veç e veç, në kontratë të përbashkët.

Neni 10
Ngarkesa për lejen e pronësisë së automjetit, parkimin dhe tërheqjen e automjetit

1. Nga banorët dhe subjektet afariste kërkohet të marrin leje për pronësinë e veturës brenda kufijve të Komunës së Fushe-Kosoves.
 - 1.1 Për të marrë një leje të tillë, banorët apo shoqëritë tregtare duhet të kenë dëshmi mbi regjistrimin e veturës tek autoritetet qendrore të Kosovës, si dhe adresën e shtëpisë apo selinë e afarizmit - biznesit të regjistruar për të punuar brenda kufijve të Komunës së Fushë-Kosovës (që do të dëshmohet me leje përkatëse të lëshuar nga MTI-ja).
 - 1.2 Tarifat për lëshimin e lejes do të paguhet në Komunë në bazë vjetore.
- 2 Të gjithë pronarët - poseduesit e automjeteve motorike, duhet të paguajnë:
 - 2.1 Për automjetet dhe automjetet-taksi:
Benzinë - naftë:
deri 3500 ccm.....10 €
mbi 3501 ccm..... 20 €
 - 2.2 Për kamionët që bëjnë transportin e mallrave:
Benzinë - naftë:
deri 3, 5 t.....10 €
mbi 3.5 t.....20 €
 - 2.3 Për autobusët:
për autobus.....20 €
- 2.4 Nga tarifa për leje për mjete motorike, lirohen të gjitha automjetet e: KFOR-it, EULEX it, përfaqësive diplomatike, emergjencës (makinat e zjarrfikësve dhe të ndihmës së shpejtë) dhe invalidët (e punës, civilë, ushtarakë dhe Veteran e UÇK-së). Provë për këtë është leja e qarkullimit të automjetit.
- 3 Ngarkesat për parkim
 - 3.1 Parkimi i automjeteve në qytetit.....0.20 €/h
 - 3.2 Rezervimi i vendparkimit për automjete të personave fizikë/juridikë.....15 €/muaji
 - 3.3 Rezervimi i vendparkimit për xhipa.....20 €/muaji
4. Nga pagesa e parkimit të automjeteve mund të lirohen kategori e caktuar e personave, me Vendim të drejtorit të organit kompetent për punët e shërbimeve publike.

5. Të gjitha ngarkesat do të paguhet përmes një autoriteti bankar të licencuar dhe do të trajtohen si të hyra vetanake të Komunës.
6. Pa dëshminë mbi pagimin e taksës nuk mund të merret automjeti.

Neni 11

1. Për shfrytëzimin dhe përdorimin e tubacionit në infrastrukturën nëntokësore nga personi i tretë në projektet e investuara nga Komuna paguhet taksa vjetore në lartësi prej 8 € në m gjatësi
2. Për investimet vetanake të personit të tretë në infrastrukturën nëntokësore hapja e kanaleve, vendosja e tubave dhe punimeve në puseta, paguhet taksa në metër gjatësi të projektit realizues në lartësi prej 3 €.
3. Nëse përdorues apo investues në projektet nga pika 11.1 dhe 11.2 e kësaj tarife është ndërmarrja publike lokale, nuk do të llogaritet kjo taksë.
4. Ndërtimi i antenave, TV, PTK, kabllave dhe të ngjashme, paguhet sipas tarifave dhe vlerave në vijim:

Tarifa I.....	4‰ (promil)	50000 €
Tarifa II.....	3,5‰ (promil)	50.000 - 100000 €
Tarifa III.....	3 ‰ (promil)	100.000 - 500000 €
Tarifa IV.....	2 ‰ (promil)	500000 €
5. Shfrytëzimi i hapësirës para objektit, në të cilin kryhen shërbimet tregtare dhe hoteliere, tarifat vjetore sipas zonave janë:

Zona I	4 €/m ² ,
Zona II.....	3 €/m ² ,
Zona III.....	2 €/m ² ,
Zona IV.....	1 €/m ² .

Neni 12

Tarifat për shërbimet komunale
Tarifat për inspektim

- 1 Inspektimi Komunal
 - 1.1 Kërkesa për kontroll inspektues jashtë qytetit me kërkesën e palës.....8 €,
 - 1.2 Kërkesa për kontroll inspektues në qytet me kërkesën e palës.....5 €.
2. Inspektimi në Ndërtimtari
 - 2.1 Kërkesa për kontroll inspektues jashtë qytetit me kërkesën e palës.....8 €,
 - 2.2 Kërkesa për kontroll inspektues në qytet me kërkesën e palës.....5 €.
3. Inspektimi i Tregut
 - 3.1 Kërkesa për kontroll inspektues jashtë qytetit me kërkesën e palës.....8 €,
 - 3.2 Kërkesa për kontroll inspektues në qytet me kërkesën e palës.....5 €.
4. Inspektimi Sanitar

- 4.1 Kërkesa për kontroll inspektues jashtë qytetit me kërkesën e palës.....8 €,
- 4.2 Kërkesa për kontroll inspektues në qytet me kërkesën e palës.....5 €.
5. Inspektimi në Bujqësi
- 5.1 Kërkesa për kontroll inspektues jashtë qytetit me kërkesën e palës.....8 €,
- 5.2 Kërkesa për kontroll inspektues në qytet me kërkesën e palës.....5 €,
- 5.3 Parashtresa tjera.....1 €.
- 6 Inspektimi në Veterinari
- 6.1 Inspektimi veterinar për kafshë (lopë, kuaj), tarifa.....5 €,
- 6.2 Inspektimi veterinar për kafshët e imëta (dele, dhi, qen, mace), tarifa.....1 €,
- 6.3 Vërtetim i lëshuar për kafshët e imëta nga ndërmarrja e licencuar, tarifa.....1 €.
7. Kontrolli inspektues për kushtet minimale-teknike në lëmin e tregtisë, hotelerisë, zejtarisë dhe veprimtarive tjera.
- 7.1 Inspektori i tregut.....15 €,
- 7.2 Inspektori sanitar.....15 €.

Neni 13

Lartësia e taksës administrative

1. Për paraqitjen e kërkesës për lëshimin e kushteve ndërtimore.....5 €;
2. Për paraqitjen e kërkesës për lëshimin e lejes ndërtimore5 €;
3. Për paraqitjen e kërkesës për lëshimin e certifikates së përdorimit.....5 €;
4. Për paraqitjen e kërkesës mbi njoftimin për destinimin e ngastrës kadastrale.....10€.

Neni 14

Tabela e Shpenzimeve për kalkulimin e Tarifave rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës

1. Tabela e Shpenzimeve për kalkulimin e Tarifave rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës janë të specifikuara në tabelën Nr. 3

Tabela e Shpenzimeve për Kalkulimin e Tarifave rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës

<i>A. Shërbimet Komunale të ndikuara nga Rritja e Popullsisë</i>		
<i>1</i>	<i>Arsimi</i>	<i>Vlera e Buxhetuar</i>
	Pagat	2,070,722.00 €
	Mallrat & Shërbimet	172,300.00 €
	Shpenzimet	77,360.00 €
	Të tjera	165,000.00 €
	Totali 1	2,485,382.00€
<i>2</i>	<i>Shëndetësia</i>	<i>Vlera e</i>

	Pagat	Buxhetuar
	Të mirat dhe shërbimet	573,200.00 €
	Shpenzimet	77,960.00 €
	Të tjera	55,000.00 €
	Totali 2	278,526.00 €
		984,686.00€
3	Shërbimet Publike, Mbrojtja dhe Shpëtimi	Vlera e Buxhetuar
	Pagat	69,095.00 €
	Mallrat & Shërbimet	39,000.00 €
	Shpenzimet	50,000.00 €
	Të tjera	475,000.00 €
	Totali 3	633,095.00€
4	Kultura, Rinia dhe Sporti	Vlera e Buxhetuar
	Pagat	64,321.00 €
	Mallrat & Shërbimet	17,000.00 €
	Shpenzimet	40,000.00 €
	Të tjera	260,000.00 €
	Totali 4	381,321.00€
	Total A = (1 + 2 + 3 + 4)	4,484,484.00€
B. Popullsia e Komunës		
	Numri i përgjithshëm i popullsisë që përdoret për alokimin e granteve gjenerale	34,816.00 b
	Tarifa për kokë banori = A/B	128.81 €

$$\left(\frac{\text{njësia e re banuese}}{\text{nr. banorëve}} \right) \times \text{Tarifa rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës për kokë banori}$$

2. Për shembull nëse aplikacioni për dhënien e lejes së ndërtimit i shtohen 1000m², hapësirë banuese, atëherë duhet të kemi parasysh se hapësira banuese, për një person duhet të jetë 50m² për kokë banori dhe tarifat rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës për kokë banori do të jetë 128.81€, prandaj taksa infrastrukturore është 2,576.11€.
3. Tabela e shpenzimeve për leje ndërtimi e taksës administrative, për metër katëror është 2.75€/m², e përcaktuar sipas Ligjit për Ndërtim 04/L-110 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2012 për Lëshimin e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës, e miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me Shkresën Nr. 701-2/13 të datës 23.04.2013.

Neni 15
Taksat dhe tarifat për dhënien e lejes mjedisore komunale

1. Taksat dhe tarifat për dhënien e lejes mjedisore Komunale janë të kategorizuar në gjashtë grupe, së bashku me shumën që duhet më paguar (çmimoren), subjektet për t'u pajisur me Leje Mjedisore Komunale si vijon:
 - 2 Grupi i parë - 500€
 - 2.1 Fabrika për përpunim druri, mobilieri, tapiceri deri $1000\text{m}^3/\text{vit}$;
 - 2.2 Fabrika për ambalazhimin e ujit natyral, mineral; me kapacitet deri në 0.5 m^3 në ditë;
 - 2.3 Fabrika për prodhimin e lëngjeve frutash, pije freskuese; pijesh alkoolike me kapacitet deri në 5 m^3 në ditë;
 - 2.4 Fabrika për përpunim të qumështit dhe produkteve të tij, deri $1000\text{ kg}/\text{ditë}$;
 - 2.5 Fabrika për përpunim të vajrave bimore, luledielli etj, me kapacitet $500\text{l}/\text{ditë}$;
 - 2.6 Prodhimi i gëlqeres (shuarja) deri $100\text{ ton}/\text{vit}$;
 - 2.7 Prodhimi i betonit dhe elementeve parafabrikate, pllakave etj. Me kapacitet deri në 50 m^3 beton/ditë;
 - 2.8 Magazinimi i lubrifikantëve të ambalazhuar në vende prodhim;
 - 2.9 Grumbullimi i mbeturinave të konstruktimit demolim për qëllime të riciklimit përfshirë seleksionimin, copëtimin mekanik dhe deponimin e tyre si dhe caktimin e vendit për deponim;
 - 2.10 Prodhimi i këpucëve dhe aksesorëve të tjerë të ngjashëm, pa procese kimike (qepje, ngjitje montim);
 - 2.11 Prodhimi i kartonit dhe ambalazheve të tjerë, me kapacitet deri $500\text{ kg}/\text{ditë}$;
 - 2.12 Rritja artificiale e peshkut në hurdha, me sipërfaqe deri në 300 m^2 .
 3. Grupi dytë -350€
 - 3.1 Pikëshitjet e gazit(GLN) deri 4.9 m^3 ;
 - 3.2 Furrat për prodhim të bukës dhe produkteve të miellit;
 - 3.3 Thertore me kapacitetet deri 3 gjedhë /ditë;
 - 3.4 Fabrika për përpunim të pemëve dhe perimeve deri në $1000\text{ kg}/\text{ditë}$;
 - 3.5 Punishtet e vogla për përpunim të mermerit, me sipërfaqe totale-objekti deri në 200 m^3 ;
 - 3.6 Ndërtimi i objekteve të banimit dhe shërbimeve, me sipërfaqe ndërtimi më të madhe se 1000m^2 ;
 - 3.7 Magazinat frigorifer, për produktet ushqimore të ambalazuara me kapacitet total magazinues deri në 50 ton;
 4. Grupi i tretë-300€
 - 4.1 Sharrimi i lëndës drunore;
 - 4.2 Pikat e magazinimit dhe tregtimit të materialeve të ndërtimit;
 - 4.3 Impiantët për rritjen intensive të shpezëve, derrave, bagëtive të imta dhe të mëdha që kanë më pak se: 2000 shpend, 100 derra, 30 gjedhë, 200 bagëti të imëta.
 5. Grupi i katërt-200€
 - 5.1 Autoserviset;
 - 5.2 Veprimtaria e prodhimit të kompostit, me sasi totale përpunimi deri në 100m^3 ose 40 ton gjatë vitit;
 - 5.3 Vendet ku janë të magazinuara, më pak se 10 ton mbeturinë inerte;
 - 5.4 Vendet ku janë të magazinuara, më pak se 2 ton mbeturinë e pa rrezikshme;

- 5.4 Impiantet për riciklimin dhe prodhimin e masave plastike me kapacitet deri 1000t/vit;
6. Grupi i pestë- 100€
- 6.1 Autolarjet;
- 6.2 Magazinimi i plehrave kimike dhe pesticideve me kapacitet magazinues deri ne 10 ton;
- 6.3 Qebaptoret dhe gjellëtoret;
- 6.4 Vendet e tregimit të kafshëve në ambient të hapur (tregjet tradicionale) ose të mbyllura;
- 6.5 Tregjet urbane industriale dhe të produkteve bimore dhe shtazore.
7. Grupi i gjashtë-të liruara, Projektet publike
- 7.1 Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitimet e tyre në gjatësi deri 5 km;
- 7.2 Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitim i ujësjellësve ekzistues në gjatësi deri 5 km;
- 7.3 Rikonstrukcion i rrugëve urbane dhe rurale ekzistuese dhe ndërtimi i akseve të reja rrugore (me gjatësi deri në 2 km);
- 7.4 Plantacionet e drurëve frutore;
- 7.5 Projektet e përmirësimit të pyjeve, pyllëzime, sistemime etj.

Neni 16

Taksat dhe tarifat tjera

1. Taksat dhe tarifat për shërbime tjera të ofruara nga Komuna janë të paraqitura në tabelën Nr. 4.

N/r	Shërbimet/aktivitetet, taksat/tarifatat/dhe gjobat	Shuma e taksës
1.	Për çdo kopje të materialit të arkivuar që kërkohet	0.20€
2.	Për çdo akt që është i lejueshëm qasja në të e që ka më shumë se 20 faqe për çdo faqe duhet paguar	0.05€
3.	Qasja në web faqen e Komunës është falas	
4.	Pëlqim për vendet (lokacionet) e propozuara për ndërtimin e objekteve afariste-banesore, tregtare, impianteve e tjera (në lëmin e mbrojtjes nga zjarri)	40.00€
5.	Pëlqim për dokumentacionin teknik që hartohet për objekte të institucioneve, objekteve afariste, tregtare, banesore, impianteve e tjera (nga lëmi i mbrojtjes nga zjarri)	500€

Neni 17

Ngarkesat për shfrytëzimin e burimeve natyrore

1. Ngarkesa për shfrytëzimin e burimeve natyrore:
 - 1.1 Materiale të palidhura dhe inerte, rëra dhe zhavorri (aluviane), m³.....1.25€
 - 1.2 Materiale të palidhura dhe inerte, rëra dhe zhavorri (në lum), m³..... 1.25€

Neni 18
Bashkëpagesat për Arsím dhe Shëndetësi

Të gjitha bashkëpagesat, tarifat dhe taksat për shërbime komunale të arsimit dhe shëndetësisë, konsiderohen si të hyra vetanake të institucionit përkatës arsimor dhe shëndetësor dhe të Komunës. Trajtimi, kontabiliteti, raportimi, monitorimi dhe verifikimi i këtyre bashkëpagesave do të bëhet në përputhje me LMFPF-në.

Neni 19
Gjobat

1. Gjobat e shqiptuara për kundërvajtje në trafik, brenda territorit të Komunës, janë të hyra vetanake dhe i takojnë Komunës. Transferet bëhen në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe do t'i përfshijnë pagesat që bëhen përmes Policisë së Kosovës dhe gjykatave, si rezultat i vendimeve gjyqësore.
2. Rregulloret Komunale të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës përmbajnë dispozitat ndëshkuese për shkeljen e dispozitave nga bartësit konkret. Lartësia e gjobës është proporcionale me fajësinë e bërë nga shkelësi i dispozitave të Rregulloreve Komunale.

Neni 20
DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët nuk i përgjigjen pagesës së taksave dhe tarifave komunale të parapara me këtë rregullore do të kërkohet ekzekutimi i dhunshëm përmes gjykatave kompetente.

Neni 21

Për të gjitha taksat, tarifat dhe gjobat që nuk janë me këtë rregullore dhe rregulloret e tjera komunale do të aplikohen taksat, tarifat dhe gjobat e caktuara me ligj dhe udhëzime përkatëse.

Neni 22

Me miratimin e kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja Komunale Nr. 01 e datës 13.01.2010 për tarifa, ngarkesa dhe gjoba dhe vendimet për ndryshime dhe plotësime.

Neni 23

Kjo Rregullore u miratua nga Kuvendi i Komunës, më datë 30.04.2013.

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditës pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Fushë-Kosovës.

